



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

P. nr. 459/15

NË EMËR TË POPULLIT

Më datë 10-01-2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me procesmbajtsten Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED], për shkak të veprës asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së sipas aktakuzes së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.2741-3/15 të dt. 20.04.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt.15.12.2016 në praninë e përf.akuzës – prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, si dhe të pandehurit me dt.15.12.2016 komunikoi këto:

### AKT GJYKIM

I pandehuri [REDACTED] nga Ferizaj, rr. [REDACTED], [REDACTED], i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar, prind i tre fëmijëve, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDACTED]

Në bazë të nen.85 dhe 86 të KPRK-së, dhe nen. 498 dhe 499 të KPPK-së, të pandehurit [REDACTED] i shqipton:

### VËREJTJE GJYQËSORE

Sepse me datë 22.08.2014, rreth orës 11.35 min, në fshatin Varosh komuna Ferizajm, duke e drejtuar automjetin në mënyrë të pakujdesshme dhe të ngarkuar jashtë standardeve ka dëmtuar pronën publike ashtu që në kamionin e tij Mercedes të firmës "Lirimi" në rimorkio kishte ngarkuar Eskavatorin dhe duke qarkulluar në rrugën kryesore që shpie për në lagjen "Musa", gjatë qarkullimit me pjesën e lartë të eskavatorit ka këputur kabllon e energjisë elektrike duke shkaktuar çrregullime me furnizim të energjisë elektrike dhe dëmtimin e pajisjeve elektrike të dëmtuarit [REDACTED].

Me të cilën ka kryer veprën penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së.

I dëmtuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna [REDACTED] ka deklaruar se hek dorë nga kërkesa pasurore juridike.

I pandehuri obligohet që emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.2741-3/15 të dt. 20.04.2015ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED] nga [REDACTED] për veprën penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 15.12.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani lexoi akuzën dhe pas leximit të

aktakuzës ndërsa pas leximit të akuzës ka deklaruar se në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe si rrethanë lehtësuese ti merr pranimin e fajlësisë, rrethanat e tij shëndetsore dhe të pandehurit ti shqiptoj vërejtje gjyqësore.

I pandehuri [REDAKTUAR], ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dhënë me autorizim të prokurorit e dt.07.10.2014, procesverbali i të dysharit Qerim Grainca i dt.10.10.2014, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.22.08.2014 si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së, ku i pandehuri me datë 22.08.2014, rreth orës 11.35 min, në fshatin Varosh komuna Ferizajm, duke e drejtuar automjetin në mënyrë të pakujdesshme dhe të ngarkuar jashtë standardeve ka dëmtuar pronën publike ashtu që në kamionin e tij Mercedes të firmës "Lirimi" në rimorkio kishte ngarkuar Eskavatorin dhe duke qarkulluar në rrugën kryesore që shpie për në lagjen "Musa", gjatë qarkullimit me pjesën e lartë të eskavatorit ka këputur kabllon e energjisë elektrike duke shkaktuar çrregullime me furnizim të energjisë elektrike dhe dëmtimin e pajisjeve elektrike të dëmtuarit [REDAKTUAR].

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin [REDAKTUAR] mori pranimin e fajlësisë, pendimin e tij të shprehur sjelljen e tij korrekte, se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kjetë i kujdesshëm dhe nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjajshme penale, se i pandehuri ja ka kompensuar në tërësi dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, dhe të pandehurit I shqiptoj vërejtje gjyqësore me bindjen se në rastin konkret edhe me shqiptimin e

vërejtjesë gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] ka deklaruar se hek dorë nga kërkesa pasurore juridike pasi që i pandehuri j aka kompensuar në tërësi dëmin e shkaktuar.


I pandehuri obligohet që emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni  
penal, P.nr.459/15 dt.15.12.2016**

**Sekretarja Juridike ,**  
Drita Ujupi

**Gjyqtari,**  
Mustaf Tahiri



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej  
15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të  
kësaj gjykate.